

Mr. sc. MENDUH BAMJA

FJALORI I SUFIZMIT

“Nuk më zë Mua as qielli im as dheu, më zë vetëm zemra e besimtarit të bindur”

Hadith Kudsi

“Ai që njeh veten, njeh Zotin” Muhammedi s.a.v.s.

HYRJE

Bazë për lëndën e këtij fjalori, kanë shërbyer fjalorët nga lëmi i sufizmit të botuar në gjuhën turke. Fjalët e përdorura në këtë fjalor, burimin e tyre e kanë në Kur'an, hadithin e Muhamedit s.a.v.s. dhe praktikën sufiste, kurorën më suptile të gjeniut mysliman.

Fjalori i sufizmave është i veçantë, ngase është përdorur dhe përdoret për shprehjen e zbulesave hyjnore në zemër dhe për shprehjen e gjendjeve dhe të shkallëve në ngritjen shpirtërore të besimtarit të sinqertë, drejt pranisë së cilësive të bukura të Krijuesit.

Duke qenë se gjuha sufiste është gjuhë e brendshme, është i pamundur përkthimi dhe komentimi i saj në gjuhën tonë të përditshme, racionale. Andaj, jemi përpjekur që me përshkrime të ofrojmë intenzitetin emocional dhe qetësinë racionale të shumicës së termave dhe të kuptimeve të tyre. Një vështëresi e veçantë gjatë hartimit të këtij fjalori ka qenë begatia e pafundme e gjuhës arabe dhe persiane. Nuk pretendojmë se kemi bërë një punë të madhe, por shpresojmë se kemi ofruar një ide fillestare për fjalorin e sufizmit në gjuhën tonë.

A

Ab (p).uji, loti. Kënaqësia e vazhdueshme në zemrën e besimtarit. Bukuria, shpirti i përkryer.

Aba (a). petkat, veshja prej zhgunit, leshit të trashë. Këtë lloj të petkave ka mbajtur edhe Muhamedi s.a.v.s.(shenjë e modestisë dhe e asketizmit). Veshja dalluese e sufive dhe e dervishëve.

Aba – ja ashkullah (a).hërka, guja prej zhgunit të Muhamedit s.a.v.s. Trashëguesit shpirtëror të këtij zhguni janë evlijat dhe dervishët, të dashuruarit ndaj Allahut xh.sh

Abad (njej. ebed) (a), koha e pafund, amshimi, përjetësia.

Abbas (a), luani, heroi, njëri prej titujve të Imam Alisë.

Abdest (p). uji për të larë duart,larja, shpërlarja e pjesëve të caktuara të trupit, kusht për të kryer namazin dhe zikrin.

Abdijet (a). rob, ai që me ndërgjegjëje i nënshtrohet rregullave të fesë

Abede-i esnan (p). njeriu i cili i adhuron idhujt.

Abid (a). besimtari i bindur. Shumë i përkushtuar ndaj besimit, ai që i kryen lutjet e shumta, i cili i kryen namazin me përpikmëri dhe përmbahet rregullave të islamit.

Ab-i hajat (p),(ab-i zindegi. ab-i xhavidani) uji i Jetës, pija e jetës së amshueshme.Gjaku, burimi dhe shkaku i jetës së amshueshme, përdoret si sinonim për ashk-i hakiki, ashk-iilahii. ilmi ledun, ab-i Hëzër, ab-i beka.

Ab-i hajavan (p). uji (lëngu) i jetës. Reflektimi i përsosshmerisë shpirtërore të irfanëve.

Ab-i revan (p),uji i (lëngu) shpirtit, zemrës. Disponimi në zemrën e myridit.

Abkari (a). njeriu i pastërt, pa. mëkate, faje, kjamil. udhëheqësi dhe sejidi i një populli.

Adab-i millije (a). populli që jeton në pajtim me ligje dhe është i ndershëm, nuk krijon trazira në botë.

Adab-i muasheret (a). jeta në bashkësi në harmoni me ligjet e Islamit. Qëndrimi ndaj njerëzve dhe komuniteteve në pajtim me ligjet e Islamit dhe traditën e Muhamedit s.av.s.

Adalet (a). sjellja në pajtim me ligjet e Islamit dhe dhënia e të drejtave të gjithëve, pa kurrfarë dallimi. Gjykimi i drejtë dhe paanësor. Zbatimi i urdhërësave të Allahut xh.sh. Edukimi i të padrejtëve (injorantëve) në frymën e drejtësisë. Madhështi.

Adalaet-i ilahije (a). drejtësia hyjnore, e Allahut xh.sh.

Adeden (a),e vërtetë, pa mëdyshje e vërteta.

Adem-abad (p), populli skamnor, i varfër, sufitet dhe dervishët.

Adem (a) (njeri, emër personal), të paraqiturit, të shfaqurit e qenies së njeriut. Njeriu i parë i krijuar.

Adem (a), mosqenie, skamje, mospasje, asgjë, hiq. Përveç Allahut xh. sh. asnjë realitet nuk ekziston.

Adem gyzij (a), njeriu relativ, i papërsosur, njeriu i ciklusit tonë.

Adem ilahiji (a), njeriu Hyjnor, mikrokosmozi hyjnor.

Adem nuranij (a), njeriu i dritës hyjnore, hijerokosmosi.

Adem runhij (a), njeriu i përshpithshëm, njeriu transcidental, metakosmosi, sophia perennis.

Adet (a), e drejta dokësore, zakon

Adlije (a), ndarja e drejtësisë në mënyrë të përpiktë, të përkryer, pa marrë parasysht prejardhjen e njerëzve, racën, gjininë, etninë etj. (Pas Muhamedit s.a.v.s. periudha e halifatit të Imam Alisë a.s.).

Afetul-myrid (a), fatkeqësia e myridit me rikthimin në mëkat, në faj, jeta kundër rregullave të tarikatit.

Afitab (p)-dielli, të zhyturit, shkrirja, të fundosurit dhe arritja në afërsi të Perëndisë afitabi xhelal (dielli i përbashkësisë) dhe afitab-i vuxhud (dielli i qenësimit), shih. wuslet.

Af-tab (p), dielli, jashtëzakonisht i bukur, i pashëm, fytyrë shumë e ndritshme.

Af-tab-i Kurejsh (p), Muhamedi s.a.v.s. dielli i fisit të Kurejshve.

Agfer-yl-gafiri (p), Falësi, Mëshiruesi i të gjitha mëkateve njerëzore, Allahu xh.sh.

Agjirimi në tarikat, të mbrojturit e gjitha pjesëve të trupit nga harami, ndalesa e gjërave të shëmtuara. Agjëruesi ka dy lumturi; lumturia gjatë iftarit dhe lumturia gjatë hyrjes në parajsë (xhenet) dhe të takimit me Allahun xh. sh.

Ah (a), ngazëllim, mallëngjim, shprehja e jashtëzakonshme e zjarrit të madh të dashuruarit, “mine’l ashk ve ahvalih ahreke kalbi bi hararetihi”. Shkronja e parë dhe e fundit e emrit Allah, bashkimi i këtyre shkronjave formon shprehjen ah, në këtë mënyrë ah dmth Allah . Shqiptimi i ah dmth Allah, me ç’rast shqiptuesi shpreh ndjenjën se gjithçka që gjindet në natyrë (njeriu, gjallesat, trupat fizikë) digjen nga flaka e zjarrit i dashurisë për Krijuesin e tyre.

Ah (p), shprehje e dhimbjes së madhe për tragjedinë e ndodhur, ah Hysein, dhembja e madhe për Hysein a.s. për tragjedinë e Qerbelasë. Zakonisht kjo shprehje përdoret gjatë dhjetë ditëve të muharremit (matemit) në teqet, gjatë kryerjes së zikrit.

Ahbab (a), miku, shoku i dashur dhe i respektuar, dervishët.

Ahbar-i gajb (a), fshehtësitë për njerëzit dhe popujt si dhe për ngjarjet që do të pasojnë në të ardhmen, të cilat janë të mbuluara me perde (velo, tisi), këto mund të deshifrojnë vetëm njerëzit e mbrishëm (mençur) dhe të zgjedhur. Indiciet për ardhjen e Muhamedit s.a.v.s. janë dhënë në librat e vjetra fetare dhe këto i kanë ditur njerëzit e zgjedhur.

Ahd (a), detyrimi, kontrata, besëlidhja, betimi.

Nakz-i ahd (a), prishje e besëlidhjes, e betimit, mospërmbajtja e betimit të dhënë.

Ahd-i atik(a), librat e vjetra fetare; Tavrati (Tora), Zeburi (Psalmet), Besëlidhja e Vjetër.

Ahd-i xhehid (a), Inxhili (Ungjilli), Besëlidhja e Re.

Ahfa (a)- brendësia e sekretit, brendësia e së brendshmes ose batin hafijje.

Ahfija (a) dhe Ahfije, sekreti, në tarikatin Mevlavi dervishët mbajnë sekret se i takojnë vëllazërisë dhe me asnjë shenje të jashtme nuk manifestojnë këtë përkatësi.

Ahkam-i kur'anije (a), sundimtarët që ushtrojnë pushtetin në bazë të Kur'anit, emirët.

Ahfija-ji ctkija (a), mbajtja në fshetësi, derisa vetë nuk zbulohen ngelin të pazbuluar, personalitetin e vet e mbajnë sekret.

Ahi (a), vëllau, guximtari, personi i cili është anëtarësuar në ndonjë shoqatë kulturore, artistike ose zejtare, pasuesi i shehut, ai që e ndjek shehun.

Ahlak (a)-sjellja e mirë, sjellje e njerëzishme, mirësjellje.

Ahlak-i hamide (a),sjellje e pëlqyeshme, cilësitë e bukura dhe të vitytëshme.

Ahlak-i kadima (a), morali i përhershëm hyjnor, ethosi qiellor, metakosmosi.

Ahlak-i ihasene (a), morali dhe mirësjellja më e lartësuar që reflektohet si dritë shpirtërore, hyjnore. Këtë cilësi e ka pasur Muhamedi s.a.v.s. dhe pasuesit më të sinqertë dhe të bindur të tij, ehli bejti

Ilmi ahlak (a), morali i dijës, sjellja e dijetarit.

Ahlak-i redie (a),zakonet e këqija, aroganca, kokëfortësia.

Ahsenul-hadis (a)-fjalimi, ligjërata më e mirë, më e bukur.

Ahval (njej.hal) (a)- gjendja, shfaqje, paraqitja në zemër, gjendja e gëzimit ose e pikëllimit, të ngushtësisë ose të gjërësisë. Zhduket me shfaqjen e personalitetit, të unit. Në rast se kjo gjendje zgjat dhe shndërrohet në cilësi, atëhere kjo emërtohet si mekam. Ahvali është dhuratë, dhunti, mekami është meritë, fitore personale. Ahvali buron nga vetë qenësimi, mekami fitohet me anë të mundit, përpjekjes.

Ahzul-ahd (a), të marrurit, pranimi i amanetit, të zotimit, të zotuarit.

Ajak myhyrlemek (t), në shumicën e tarikateve, mënyrë e veçantë e përshëndetjes së shehut; duke shkelur gishtin e madh në këmbën e majtë me gishtin e madh të këmbës së djathtë dhe duke mbajtur dorën e djathtë në drejtim të zemrës e dorën e majtë përfundi saj.

Ajakhxi (t), në tarikatën Mevlevi, dervishi i parë sipas rradhës së pranisë në tarikat.

Ajan (a), syri, burimi.

Ajani sabite (a), ekzistenca reale e sendeve në dijen gjithëpërfshirëse. Forma e objekteve, e gjithë krijesave ka ekzistuar së pari në dijen e Allahut xh. sh. para se të zbresin dhe të japin formën gjithë botës materiale. Mbulesa e të gjitha krijesave ka ekzistuar dhe ekziston në dijen e Allahut xh.sh.

Ajan tabita (a), realitetete e sekrete, arketipet e mbuluara, arketipet dhe pamjet arkaike.

Ajar (a), njeriu i zhdërvjelltë, i cili gjithmonë në lëvizje. Me rastin e dobësimit të shtetit dhe të shoqërisë, paraqitja e njerëzve që krye në vete rregullojnë jetën e një bashkësie të vogël, udhëheqësit e grupeve asociale, grupet e hajdutëve. Në sufizëm njerëzit trima dhe zemërgjërë, që gjithçka edhe jetën e vet e flijojnë në rrugën e tarikatit.

Ajat (a), mrekullirat, shenjat , ajetet Kur'anore, të cilat qartësisht pasqyrojnë gjithëfuqinë dhe cilësitë e Allahut xh. sh. Gjendja në shkallën e xhemit. Mbulimi, veshje me dritën hyjnore dhe vëzhgim i gjithë botës, pamje me syrin e zemrës, pamje vetëm të Njënisë të Allahut xh.sh. Gjendjet dhe mrekullirat e njerëzve të përsosur, pjeknuar.

Ajati kibrija (a), si është thënë më lart, si ajat.

Ajin (p), rregullat, zakonet, ligji. Brenda tarikatit rregullat obliguese të sjelljes ndërmjet anëtarëve; mënyra e virdit, zikrit, sema-së etj.

Ajine (p), krijesat e Allahut xh.sh. të krijuara me qëllim të vëzhgimit të bukurisë, madhështisë dhe të lartësisë së Tij, pasqyra, pasqyra ku me dashurinë dhe vulnetin e Allahut xh.sh. reflektohen cilësitë e Tij. Reflektimi i Esmā yl-Hysna-së.

Ajine-i dil (a), pasqyra e zemrës. Vendi i reflektimit të cilësive të Allahut xh.sh. dhe vendi të cilin e vëzhgon Ai.

Ajin-han (p), recituesi i ilahive. Në tarikatin Mevlevi gjatë sama-s kompozitori i ilahive si dhe recituesi.

Ajine-i vuxhud (p), pasqyra e qenësisë së qenieve, gjithë krijesat, gjithësia.

Ajine-i xhem (p), festat për nder të perëndisë së verës në Iranin e vjetër të emërtuara si Xhem dhe Xhemshid. Në tarikatin Bektashi dhe në disa tarikate të tjera organizimi i gazmendeve të përcjella me muzikë dhe me përdorimin e verës. (Në disa tarikate këtyre gazmendeve u bashkohen edhe gratë). Rregullat dhe morali, mënyra e jetës dhe e sjelljes në tarikatin Bektashi.

Ajine-i xhemal/Ajine-i hysn (p), pasqyra e bukurisë dhe shkalla e cila reflekton cilësitë e larta e të bukura.

Ajin-i chlullah (p-a), rregullat e tarikatit, rregulla të vendosura nga ana e themeluesit të tarikatit. Rregullat e vendosura nga ana e shehut ose mëkëmbësit të tij të cilat duhet të respektohen nga ana e dervishëve gjatë ceremonive fetare (zikrit). Rregullat të vendosura nga themeluesi i tarikatit, shembëlltyra e tij, mënyra e sjelljes, jetesës kanë vetëm një qëllim, rrugën e afrimit Perendisë. Në tarikatin Kaderi, zhvillimi i ritualit të këtyre (zikrit), quhet devran, në tarikatin Mevlevi sema ose mukabele, te Rufait dhe Saaditë zikr-i kijam, te Xhelvetit nisf kijam, te Halvetit darb-i esma, te Shazelit hadra dhe te Nakshibendit hatm-i haxhegan. Në shumë tarikate gjatë zhvillimit të zikrit recitohen ilahitë të përcjellura me instrumente.

Ajin-i kadim (p), rregullat e vjetra, zakonet e vjetra. Në tarikatin Mevlevi gjatë sema-së recitimi i ilahive autorët e të cilave nuk dihen.

Ajin-i kebir (p), rregullat më të larta. Në tarikatin Mevlevi dhe Bektashi rregullat më të rëndësishme, thelbësore, themeltare, si sema ajini dhe ajin-i xhem.

Ajin-i nijaz (p), rregullat e përshëndetjes, të uratës. Në tarikatin Bektashi, me rastin e lutjes për bekimin, lutjen për mirëqenie ose të shërimit nga ndonjë e ligë, mënyra e veçantë e qëndrimit kokëulur dhe shikimit të ulur. Në tarikatin Mevlevi pas kryerjes të sema-s me qëllim të plotësimit të dëshirave, vazhdimi i ceremonialit.

Ajin-i sykvari (p), ceremonial i cili zhvillohet gjatë matemit, ceremoniali i zisë. Te shiitët dhe në të gjitha tarikatat në ditën e dhjetë të muajit muharrem, zhvillohet ceremoniali i veçantë, me rastin e shënimit të tragjedisë së Qerbelasë. Me këtë rast pjesëmarrësit përkujtojnë ngjarjet dhe personazhet e tragjedisë, vajojnë e në disa raste shkulin edhe flokët dhe i bien murit me kokë, vetëprehen në gjoks me thika të vogla, me zinxhirë i sjellin shpinës.

Ajin-i sherif (p), në tarikatin Mevlevi emërtim tjetër për sema-në. Në tarikatin Mevlevi hymnat, poemat të cilat recitohen, ilahitë e Mevlevive. Gjatë zhvillimit të sama-as recitimi i poemave dhe hymneve të Mevlanës të përcjella me muzikë. Zikri që bëhet në këmbë (kijam).

Ajin-i xhem (p), rregullat dhe morali, mënyra e jetës dhe e sjelljes në tarikatin bektashian.

Ajip (t), turpi, koritja, faji. Ai që është i vetëdijshëm për fajin e vet.

Ajn (a), syri, burimi, qenie e përbashkët kjo qenie i takon vetëm Allahut xh. sh. (Malum). burimi, baza, materia, qenja.

Ajna (a-t), pasqyre. Zemra e njeriut të përkryer. Reflektimi i cilësive dhe bukurive të Allahut xh.sh. te njeriut, të cilin Ai e don. Prej të gjitha cilësive të bukura që janë pa fund, Allahu xh.sh. si mëshirues i ka dhuruar njeriut. Tërë gjithësia paraqet reflektimin e cilësive të bukura të Allahut xh.sh. Allahu xh.sh. me cilësitë më të bukura i ka pajisur velitë (evlijat), nebijtë (të dërguarit) dhe rusultë (profetët). Allahu xh.sh. Muhamedit s.a.v.s. i ka dhuruar cilësitë më të bukura, përkatësisht te Muhamedi s.a.v.s. janë reflektuar në mënyrë të përsosur cilësitë e Allahut xh.sh. Besimtari i bindur (mumini) është pasqyra e besimtarit të bindur (muminit), përkatësisht besimtari pasqyrën e vet e ka te besimtari tjetër tek i cili sheh mangësitë e veta dhe të besimtarit tjetër; me ç'rast besimtari pastron veten përvetëson virtytet e bukura të tjetrit, por njëkohësisht shërben edhe si shembull për besimtarin tjetër. Shehu është pasqyrë për dervishin dhe anasjelltas. Drita hyjnore prej el-Hakut buron drejt Pirit dhe nëpërmes tij muridëve dhe dervishëve. Zemra e besimtarit të bindur (muminit) sa më tepër pastrohet, aq më tepër e përfshin drita hyjnore në burimin e pandrëprerë të mëshirës.

Ajne'l jakin (a), shikim për së afërmi, nga afërsia. Fitimi i bindjes nga dëshmia dhe zbulesa në zemër. Ilme-l jakin, ajne'l jakin dhe hakke'l jakin paraqet shkallën e dytë, të tria shkallëve të pamurit, të vëzhgimit nga afërsia. Zemra që sheh në realitet Njëninë e Qenies,. Vëzhgimi me anë të zemrës të wâhdad al wuxhud.

Ajn-i sabite (a), ekzistenca reale e sendeve në dijen e Allahut xh.sh. Prania e përhershme në dijen e Allahut xh.sh.

Ajn-i keramet (a), kerametet, mrekullitë, veprat e jashtëzakonshme të pejgamberëve dhe të evlijave.

Ajn-i kilit (a), farë, tharri ku janë rrumbullakësuar, përfshirë tetëmbëdhjetë mijë botëra.

Ajnu'l alem (a), syri i popullit, masës (merdum-i dide-i ekvan), njeriu i përsosur, i përkryer (insani kamil). Syri hyjnor.

Ajnu'l fena (a), gjendja e vërtetë e fana-së (fena ender fena), shih fena.

Ajnu'l- hajat (a), jeta e vërtetë, ab-i hajat. Kuptimi i brendshëm , brendësia el-Hajit, njerit prej emrave të bukura të Allahut xh.sh.

Ajnu'l kalb (a), syri i zemrës. Depërtimi, arritja në sferën sekrete.

Ajnu'l mahabet (a), kuvendimi i lartësuar, kuvendimi i të dashuruarve të Allahut xh.sh. Në këtë gjendje besimtari është i pastruar prej çdo dashurie egoiste dhe të epsheve. Ai don vetëm ato, që don Allahu xh.sh.

Ajnullah (a), syri i Allahut xh. sh. Ai që ka arritur në shkallën e përvetësimit të emrit të Allahut xh.sh. el-Basir, sheh (vëzhgon) të gjitha sendet me ndihmën e syrit të Allahut xh.sh. Personi i cili sheh sekretet e larta me syrin e Allahut x.sh. njeriu i përkryer, pjeknuar. Ndërsa drita e syrit të botes-gjithësisë është njeriu.

Ajnu'sh shej (a), thelbi (lartësia) e një sendi.

Ajnu't tahakum (a), burimi i mundësive, i forcës. Dëshira e njeriut të lartësuar (veliutë) për të treguar gjendjen e vet. Plotësimi i lutjeve dhe dëshirave të besimtarit të lartësuar nga ana e Allahut xh.sh. Shfaqja e gjendjes e mrekullive të jashtëzakonshme me ndihmën e Allahut xh.sh.

Ajnu'l xhem (p), gjendja e xhemit. Gjendja ku sufiu qartë vëzhgon se përveç Allahut xh.sh. çdo krijesë është kaluese. Tërë shumësia dhe pasuria është (i takon) vetëm e Allahut xh.sh. Në këtë gjendje sufiu thotë se përveç Allahut xh.sh. asgjë nuk ekziston (la faile illallah, la mehshude illallah). Sufitë më të përmendur të kësaj shkallë kanë qenë Bajezid Bistami: “Unë nuk ekzistoj, e lartë (e madhërishtme) është pamja ime” dhe Mensur Hallaxhi (“Ene'l Hak”). Në këtë shkallë sufitet ngrihen në wahdat al wugud (monizmin ekzistencialist).

Ajnu'l xhem ose ajn-i xhem (p), në tarikatin Mevlevi zhvillimi i ceremonialit të zikrit me ç'rast me petka të veçanta dervishët dhe shehu të percjellë me instrumente muzikore recitojnë ilahitë dhe zhvillojnë sema-në. Shoqërimi i

dervishëve ndërmjet tyre si vëllezër, shkatërrimi i çdo egoizmi. Ky lloj shoqërimi paraqet syrin dhe pasqyrën e çdo dervishi në tarikat.

Ajsh (a), jeta (ajsh u nush, zevk u sefa). Të jetuarit real, me ndjenjën e pranisë së Perëndisë. Përvetësimi dhe të kuptuarit të jetës reale, ngritja për të jetuar në praninë e Perëndisë.

Ajnul-jekin (a), bindja e fituar nga dëshmia dhe zbulesa, e shikimit, e vëzhgimit me syrin e zemrës.

Ajn-u tehakkum (a), dëshira për të treguar shkallën e arritur në ecurinë e tarikatit.

Akl (a), mendja, arsyeja, gjuha e jashtme. Paafëësia e sqarimit të Vërtetës thelbësore, të gjykuarit mbi sendet ashtu siç janë, ashtu si paraqiten, aftësia e të gjykuarit.

Akl-i evel (a), mendja parakrijuese, Intelkti i Parë, njëra prej emërtimeve për Lehv-i kaza-n.

Akl-i ilahi (a), arsyeja e Allahut xh.sh.në krijimin dhe rregullimin e të gjitha botërave.

Akl-i kamil (a), mendja e plotë, arsyeja e përsosur, mendja e pjekënuar.

Akl-i kyl (a), mendja e parë e shfaqur me Gjithëfuqinë e Allahut xh.sh. Arsh-i azami,

Xhebraili a.s., drita (nuri) i Muhamedit s.a.s.v.

Akl-i mead (a), mendja, arsyeja që mund të përfshijë ngjarjet e ardhshme. Mendja e lidhur me parajsën.

Akl-i mear (a), mendja e cila mendon, mediton nga kemi ardhur dhe ku do të kthehemi.

Akl-i meash (a), mendja e cila shërben në jetën e përditëshme, mendja praktike, mendja e lidhur me jetën e kësaj bote.

Akrebijet devri (a), afrimi kah Allahu xh. sh.

